



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF
GJAKOVA



Zyra e Prokurimit
Komuna e Gjakovës

Në bazë të nenit 72.1 të Rregullores për Prokurim Publik të dt. 01.11.2022, nenit 20.1, nenit 38, të Kushteve të Përgjithshme të Kontratës (KPK) dhe kërkesës së menaxherit të kontratës me numër identifikimi : 632-19-670-5-1-1 dhe numër të brendshëm 632-19-003-511 dhe nr. të protokollit 01nr.410/04-33091, për shkak të pamundësisë së përmbushjes së obligimeve kontraktuale nga ana e Kontraktuesit, në bazë të kompetencave dhe përgjegjësi ligjore më dt. 23.10.2024, Zyrtari përgjegjës i prokurimit, Ju njofton:

NJOFTIM

Për ndërprerjen me marrëveshje të Kontratës

Neni 20, paragrafi 20.1 i KPK përcakton se "Palët duhet t'i bëjnë të gjitha përpjekje për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për qëndrimet e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën"

Neni 38, paragrafi 38.1 i KPK përcakton se: "**Force Madhore**" siç përdoret këtu mendohet në çrregullimet industriale, çrregullimet civile, luftërat, eksplozimet, tërmeti, zjarret, vërshimet, epidemitë etj e shkaktuar jo me fajin apo neglizhimin e palëve kontraktuese, e paparashikueshme dhe jashtë kontrollit të palëve kontraktuese.

Me dt.22.10.2024, menaxheri i kontratës i është drejtuar Zyrës së Prokurimit, me kërkesë për shkëputjen me marrëveshje të kontratës "**Ndërtimi Qarkores, vazhdimi I rrugës "Bujar Roka"**", e lidhur me dt.30.08.2019, me numër të prokurimit : 632-19-670-5-1-1 , numër të brendshëm 632-19-003-511 dhe nr. të protokollit 01nr.410/04-33091;

Sipas Menaxherit të kontratës, në vitin 2020 dhe 2021, pandemia globale COVID-19 shkaktoi vonesa të papritura dhe të pakontrollueshme në realizimin e projekteve publike. Në të njëjtën kohë, çmimet e materialeve ndërtimore dhe të shërbimeve u rritën ndjeshëm, duke e bërë të pamundur për Operatorin Ekonomik që të realizonte detyrimet kontraktuale sipas kushteve fillestare. Operatori Ekonomik SH. Drini Company, K. Prizren ka hasur në vështirësi të papara për shkak të pandemisë dhe rritjes së çmimeve, prandaj duke marrë parasysh vështirësitë ekonomike dhe operacionale, të dyja palët, Komuna e Gjakovës dhe SH. Drini Company, K. Prizren, kanë arritur në përfundimin se ndërprerja e kontratës është zgjidhja më e arsyeshme dhe e drejtë për të dy palët. Kjo marrëveshje është bërë me mirëkuptim të plotë dhe në përputhje me dispozitat ligjore që rregullojnë marrëdhëniet kontraktuale.

Andaj, bazuar në nenin 20, paragrafi 20.1 dhe nenin 38, paragrafi 38.1 të KPK, si dhe kërkesën e dt.22.10.2024, të menaxherit të kontratës, palët kontraktuese kanë arritur në përfundim që të bëhet ndërprerja e kontratës me marrëveshje mes dy palëve kontraktuese.

Nga sa u tha më lartë, ju informojmë se kontrata e nënshkruar me datën 30.08.2019, me numër të prokurimit: : 632-19-670-5-1-1 dhe numër të brendshëm 632-19-003-511 dhe nr. të protokollit 01nr.410/04-33091, me titull “: **“Ndërtimi Qarkores, vazhdimi I rrugës “Bujar Roka”**”, ne mes të Komunës së Gjakovës dhe kryesit të punëve **SH. “Drini Company” SH.P.K. & “ INTRAST “ SH.P.K – Prizren**, do të ndërpritet me marrëveshje mes dy palëve me date 24.10.2024.

Palët janë pajtuar që nuk do të ketë kërkesë për dëmshpërblim nga ana e Kontraktuesit e as penalizim nga ana e Autoritetit kontraktues.

Shkresës i bashkëngjiten kërkesa e Operatorit ekonomik dhe rekomandimi i Menaxherit të kontratës për shkëputje të kontratës.

Me respekt,

Udhëheqës i zyrës së Prokurimit





Republika e Kosovës
Republika e Kosovës
Republic of Kosovo

GJAKOVA



Komuna Gjakovë
Opština Gjakovica
Municipal of Gjakova

DATË:	22.10.2024
REFERENC-Ë:	01/zirt.2024
PËR/ZA/TO:	Zyra e Prokurimit, z. Faton Gutaj – Gjakovë
CC:	Kryetarin e Komunës – z. Ardian Gjini
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Drejtoria për Infrastrukturë – z. Shkumbin Kastrati
NGA/OD/FROM	Projekt Menaxheri – Rexhë Rexha
TEMA/SUBJEKT/SUBJECT:	Kërkesë për Ndërprerje të Kontratës me Pajtimin e Palëve

Përsëritje:

Përmes kësaj shkrese ju njoftojmë për kërkesën e paraqitur nga ana e Operatorit Ekonomik SH. Drini Company të datës 08.04.2024 që me mirëkuptim të mundësoj shkëputjen e kontratës : Ndërtimi i Qarkores – Vazhdimi i rrugës Bujar Roka me nr. të prokurimit 632-19-003-511 në vlerë prej 3,580,435.49€.

Data e nënshkrimit të kontratës: 30.08.2019

Palët e kontratës:

- **Autoriteti Kontraktues:** Komuna e Gjakovës dhe
- **Operatori Ekonomik:** SH. Drini Company, rr. Xhemil Flugu” I lam B/48 K. Prizren

1. Hyrje dhe Kontekst:

- Komuna e Gjakovës nënshkroi një kontratë me Operatorin Ekonomik SH. Drini Company më 30.08.2019 për realizimin e projektit "Ndërtimi i Qarkores, vazhdimi i rrugës Bujar Roka." Gjakovë.
- Ky projekt është një pjesë thelbësore e përmirësimit të infrastrukturës rrugore – Tranziti Jugor dhe synon të ofrojë lehtësira në transport për qytetarët e komunës së Gjakovës si dhe rrugë lidhëse me Republikën e Shqipërisë. Megjithatë, në vitin 2020 dhe 2021, pandemia globale COVID-19 shkaktoi vonesa të papritura dhe të pakontrollueshme në realizimin e projekteve publike. Në të njëjtën kohë, çmimet e materialeve ndërtimore dhe të shërbimeve u rritën ndjeshëm, duke e bërë të pamundur për Operatorin Ekonomik që të realizonte detyrimet kontraktuale sipas kushteve fillestare.

Arsye për Ndërprerjen e Kontratës me Pajtimin e Palëve

2. Arsytimi për Ndërprerje me Pajtimin e Palëve:

Operatori Ekonomik SH. Drini Company, K. Prizren ka hasur në vështirësi të papara për shkak të faktorëve të mëposhtëm:

- **Efektet e Pandemisë COVID-19:** Pandemia shkaktoi mbyllje të gjera ekonomike dhe kufizime në lëvizjen e materialeve dhe fuqisë punëtore. Këto kushte bënë të pamundur zbatimin e projektit brenda afateve të përcaktuara në kontratë.
- **Rritja e Çmimeve:** Gjatë periudhës së pandemisë dhe më tej, çmimet e materialeve ndërtimore u rritën ndjeshëm, duke rritur në mënyrë të konsiderueshme kostot operative. Si rezultat, Operatorit Ekonomik nuk i është mundur që të realizojë punimet e kontraktuara brenda buxhetit të parashikuar, pa pësuar humbje të mëdha financiare.

3. **Marrëveshje të përbashkët:** Duke marrë parasysh vështirësitë ekonomike dhe operacionale, të dyja palët, Komuna e Gjakovës dhe SH. Drini Company, K. Prizren, kanë arritur në përfundimin se ndërprerja e kontratës është zgjidhja më e arsyeshme dhe e drejtë për të dy palët. Kjo marrëveshje është bërë me mirëkuptim të plotë dhe në përputhje me

dispozitat ligjore që rregullojnë marrëdhëniet kontraktuale. Është bërë vlerësimi i punimeve të kryera dhe është bërë preja e punimeve të ngelura pa u përfunduar.

4. Justifikimi Ligjor dhe Procedural:

Sipas nenit nr. 38, të dy palët kanë të drejtë të ndërpresin kontratën me marrëveshje të ndërsjellë kur ekzistojnë arsye objektive dhe të justifikuara, siç janë forca madhore (pandemia COVID-19) dhe ndryshimet e papritura në treg (rritja e çmimeve). Ky hap është ndërmarrë për të mbrojtur interesat e përbashkëta dhe për të shmangur kosto shtesë për Komunën dhe për Operatorin Ekonomik.

5. Përfundim:

Në përputhje me situatën e krijuar dhe në frymën e bashkëpunimit, palët duhet rënë dakord që të ndërpresin kontratën për projektin " **Ndërtimi i Qarkores – Vazhdimi i rrugës Bujar Roka** ".

Të dyja palët janë të pajtuara që ky vendim është në të mirë të interesave të tyre dhe në përputhje me parimet e drejtësisë dhe transparencës.

Menaxheri i Kontratës

Rexhë Rexha





SH.Drini Company

Rr "Xhemil Flugu" IlamB/48,
Prizren
Tel: 045/960-880

KËRKESE

Me anë të kësaj kërkesë, kërkojm nga Komuna e Gjakoves-Drejtoria e Sherbimeve Publike që me mirëkuptim të na mundësoj shkëputjen e kontrates: **Ndertimi I Qarkores ,vazhdimi I rruges "Bujar Roka" Gjakovë, me Nr: 632-19-003-511.**

Arsyeja është sepse kjo kontrat është shumë e vjetër, ku njoftimi i kësaj kontrate është bërë: 20.06.2019, me nr.te kontrates: 632-19-003-511, ndersa nenshkrimi i kesaj kontrate është me date: 30.08.2019. Arsyeja për mos realizimin e kësaj është: situata që u krijua nga COVID-2019 në vitet 2020-2021 dhe më pas lufta në Ukrain, ku të gjitha ngjarjet u shënderruan në krizë globale ku çmimet e lëndës së parë pësuan ndryshime të mëdha respektivisht ngritje të mëdha, dhe neve si biznes na shpie në vështësi të mëdha në realizimin e kësaj Kontrate.

Si pasojë e këtyre asyeve të lartëcekuar kërkojm shkëputjen e kontratës me mirëkuptim.

Mbetemi me shpresë që bashkëpunimi jonë me Institucionin tuaj do të vazhdoj edhe në të ardhmen me projete te tjera.

Me respect:

SH."Drini Company"shpk-Prizren

Datë: 08.04.2024

Prizren

